



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 56

Prishtinë, më 7.10.2016 në ora 23:15

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Xhavit Haliti, Bislim Zogaj, Fatmir Xhelili, Arben Gashi, Donika Kadaj- Bujupi, Time Kadriaj dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Valdete Bajrami, Slobodan Petroviç dhe Vjosa osmani.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Njomza Emini, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-120 për Trepçën, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-120 për Trepçën, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja, lidhur me këtë projektligj, paraqiti opinionin ligjor, si vijon:

Projektligji nr. 05/L-120 për Trepçën, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, janë shqyrtuar dhe është konstatuar se fusha që rregullon ky projektligj, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian, përkatësisht Acquis të BE-së, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Pasi nuk kishte diskutues, Projektligjin e paraqiti për votim, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional.

Kryetarja, pas votimit, konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 05/L-120 për Trepçën, së bashku me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, janë shqyrtuar dhe është konstatuar se fusha që rregullon ky projektligj, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacionin e Bashkimit Evropian, prandaj mund të rekomandohet për miratim në procedurë të rregullt në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 23:20.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Njomza Emini